

UDHËZIM
Nr. 1090, datë 12.12.2024

**PËR PROCEDURAT E PLANIFIKIMIT DHE ZBATIMIN E ARSIMIT DHE
FORMIMIT PROFESIONAL NË FORMËN E DYFISHTË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, i cili përcakton se ministri, nën kompetencën e tij nxjerr urdhra dhe udhëzime; si dhe në mbështetje të nenit 6, pika 10, dhe të nenit 12, pika 1, të vendimit nr. 691, datë 6.11.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimit të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë”,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave për planifikimin e zbatimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional në bashkëpunim me punëdhënësin, duke përfshirë edhe detyrat e përgjegjësitë e mësuesit të kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit dhe të kujdestarit të praktikës profesionale.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të vendosë standarde minimale të detyrueshme për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit në zbatim të procedurave për planifikimin, për zbatimin dhe për monitorimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional në bashkëpunim me punëdhënësin, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.

Neni 3
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë kuptimin që kanë në legjislacionin për arsimin dhe formimin profesional (përmendur në vijim si “AFP”), ligji nr. 15/ 2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar; ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dhe legjislacionin në fuqi, për ushtrimin e veprimtarisë së ofruesve të AFP-së.

KREU I
**PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE PËR ZBATIMIN E KONTRATËS PËR MËSIMIN E
PROFESIONIT NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË FORMËN E DYFISHTË**

Neni 4
Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional

Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për zbatimin e këtij udhëzimi, ka këto detyra e përgjegjësi:

1. Hap dhe mbyll programet e arsimit profesional të niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, që ofrohen në formën e arsimit dhe formimit profesional të dyfishtë, në përputhje me aplikimin e bërë nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional.

2. Miraton programin e trajnimit të mentorëve për udhëheqjen e nxënësve që mësojnë profesionin, në vendin e punës, të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Neni 5

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

AKPA-ja, për zbatimin e këtij udhëzimi, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Miraton lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional dhe punëdhënësve për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit.

2. Mban, përditëson dhe publikon informacion mbi programet, institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, si dhe punëdhënësit më të cilën institucionet kanë lidhur marrëveshje.

3. Harton dhe përditëson listën në rang vendi të punëdhënësve që angazhohen në të gjitha institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë arsim dhe formim profesional në formën e dyfishtë.

4. Informon rregullisht ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, duke u vënë në dispozicion listën e punëdhënësve me të cilët kanë lidhur marrëveshje institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional dhe të nxënësve që mësojnë profesionin.

5. Mbledh nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional nevojat për mësues të kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit dhe i përcjell në ministrinë përgjegjëse për miratim.

6. Harton dhe përditëson listën e mentorëve, të angazhuar në zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, që duhet të ndjekin programin e trajnimit sipas përcaktimeve të nenit 6/6 të VKM-së nr. 691, datë 6.11.2024.

Neni 6

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

AKAFPK-ja, për zbatimin e këtij udhëzimi, ka këto detyra e përgjegjësi:

1. Harton skeletkurrikulat që zbatohen nëpërmjet arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë, në përputhje me standardet e kualifikimeve profesionale përkatëse të niveleve 2 deri në 5 të KSHK-së.

2. Harton programet orientuese për provimin e Maturës Shtetërore Profesionale të nivelit 4 të KSHK-së, të zbatuara nëpërmjet arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë.

3. Harton formatin e planit mësimor në vendin e punës për mësimin e profesionit përmes arsimit të dyfishtë, dhe planit mësimor në institucionin ofrues të arsimit dhe formimit profesional, për zbatimin e skeletkurrikulës përkatës nëpërmjet arsimit të dyfishtë.

4. Mbështet institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional dhe punëdhënësit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, përmes arsimit të dyfishtë, me instrumente didaktike për mbarëvajtjen e planit mësimor në vendin e punës.

5. Harton programin e trajnimit për certifikimin e mentorëve.

6. Mbështet zhvillimin e kapaciteteve të mësuesit të kulturës profesionale, përgjegjës për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit.

Neni 7

Institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional

Institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional për zbatimin e këtij udhëzimi, kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Identifikojnë nevojat për kualifikimeve profesionale të ofruara në formën e dyfishtë dhe propozojnë hartimin e kualifikimeve të reja ose rishikimin atyre ekzistuese.

2. Ofrojnë kualifikime profesionale në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë, që bëjnë pjesë në nivelet 2, 3, 4 dhe 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, të ofruara në përputhje me shkronjën “c”, të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

3. Aplikojnë përpara fillimit të vitit shkollor për ofrimin e kualifikimeve nëpërmjet formës së dyfishtë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Publikojnë përpara fillimit të vitit shkollor në mjediset publike të institucionit dhe në rrjetet zyrtare, informacion mbi kualifikimet profesionale që do të ofrohen në formën e arsimit të dyfishtë.

5. Koordinojnë zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, e cila është e vlefshme për të gjithë nxënësit që ndjekin arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë, me përjashtim të nxënësve në klasën e 10-të, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

6. Identifikojnë dhe përzgjedhin punëdhënësit që plotësojnë kriteret për të zbatuar kontratën për mësimin e profesionit.

7. Kërkojnë miratimin për lidhjen e marrëveshjeve së bashkëpunimit me punëdhënësit që plotësojnë kriteret në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

8. Lidhin marrëveshje bashkëpunimi me punëdhënësit e miratuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit.

9. Hartojnë, mbajnë dhe përditësojnë dosjet e punëdhënësve, që plotësojnë kriteret për të ofruar kualifikimet në formën e dyfishtë.

10. Mbikëqyrin mbarëvajtjen e zbatimit të programit profesional përkatës të punëdhënësi, ku zbatohet kontrata e mësimin të profesionit në formën e dyfishtë.

11. Koordinojnë dhe dokumentojnë vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin përfundimtar të nxënësve, që mësojnë profesionin gjatë mësimin të profesionit në formën e dyfishtë në bashkëpunim me mentorët pranë punëdhënësit.

12. Caktojnë mësuesit e kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, për të mbështetur nga afër veprimtarinë e nxënësve, që mësojnë profesionin në procesin mësimor në shkollë dhe në vendin e punës.

13. Ngarkojnë mësuesit e kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, për hartimin e një raporti vjetor për vlerësimin e bashkëpunimit me punëdhënësit.

14. Angazhojnë kujdestarët e praktikës profesionale në zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit nëpërmjet formës së dyfishtë sipas legjislacionit në fuqi.

15. Trajnojnë dhe certifikojnë mentorët, pa pagesë, sipas programit të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

16. Lëshojnë certifikatë profesionale dhe suplementin përkatës në përfundim të studimeve, sipas niveleve të KSHK-së, në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësit, për zbatimin e këtij udhëzimi kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. Bashkëpunojnë me institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për ofrimin e kualifikimeve profesionale në formën e dyfishtë.

2. Nënshkruajnë dhe garantojnë zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit me nxënësit që mësojnë profesionin, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi. (Shtojca 1, “Model kontratë për mësimin e profesionit”).

3. I paguajnë një pagesë mujore nxënësit që mëson profesionin për punën që kryen gjatë, sipas shtojçës bashkëlidhur këtij udhëzimi mësimi të profesionit sipas legjislacionit në fuqi.

4. Caktojnë një anëtar të stafit si mentor, i cili duhet të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë profesionale dhe mund të udhëheqë deri në 5 (pesë) nxënës që mësojnë profesionin.

5. Pasqyrojnë në përshkrimin e përgjegjësiave të punës të mentorit detyrat dhe përgjegjësitë që ka në lidhje me zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit dhe udhëheqjen e nxënësve që mësojnë profesionin të përcaktuara në VKM-në përkatëse.

6. Sigurojnë vendin e punës, mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit për çdo nxënës.

7. Dokumentojnë realizimin e kontratës dhe angazhohen në vlerësimin e nxënësit, që mëson profesionin përgjatë punës.

8. Lëshojnë vërtetim/letër reference në fund të realizimit me sukses të kontratës për mësimin e profesionit.

9. Ndërpresin në çdo kohë, në përputhje me parashikimet e dispozitave të Kodit të Punës, marrëdhënien e punës me nxënësin që mëson profesionin, nëse ky i fundit nuk respekton detyrimet e marra përsipër prej tij, në bazë të kontratës së punës për mësimin e profesionit.

10. Zbatojnë dispozitat ligjore, të cilat rregullojnë punën e punëmarrësit të grup-moshës 16 (gjashtëmbëdhjetë) deri në 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, si dhe dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve në punë, në rastet kur nxënësi që mëson profesionin nuk ka mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Neni 9

Zyrat rajonale të punësimit

Zyrat rajonale të punësimit, për zbatimin e këtij udhëzimi, kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Mbështesin punëdhënësit e angazhuar për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit në publikimin e vendeve vakante për mësimin e profesionit në Portalin Kombëtar të Punësimit dhe Aftësive;

2. Mbështesin institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional në krijimin e profilit të nxënësve që mësojnë profesionin në Portalin Kombëtar të Punësimit dhe Aftësive.

KREU II

DETYRAT E STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE PËR PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN, MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E ARSIMIT DHE TË FORMIMIT PROFESIONAL NË FORMËN E DYFISHTË

Neni 10

Strukturat përgjegjëse për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë

1. Strukturat përgjegjëse për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e kontratës së punës për mësimin e profesionit gjatë mësimi të profesionit në formën e dyfishtë janë:

- a) drejtori i institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional;
- b) zëvendësdrejtori i kulturës profesionale të institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional;
- c) përgjegjësi i departamentit të drejtimit/profilin mësimor ku ofrohet arsimi në formën e dyfishtë;
- ç) koordinatori i zhvillimit të kurrikulës së institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional;
- d) koordinatori për marrëdhëniet me biznesin i institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional;
- dh) mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit;
- e) kujdestari i praktikës profesionale;
- ë) mentori pranë punëdhënësit.

Neni 11

Drejtori i institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional

1. Drejtori i institucionit në raport me zbatimin e programeve të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë ka këto detyra:

a) drejton dhe mbikëqyr procesin e përzgjedhjes së kompanive trajnuese për arsimin e dyfishtë në përputhje me kriteret e paracaktuara;

b) lidh dhe ndjek zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për ofrimin e arsimit të dyfishtë me kompanitë trajnuese për arsimin e dyfishtë (shtojca 2, “Marrëveshje bashkëpunimi ‘Për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë’”);

c) menaxhon dhe organizon zbatimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë në Institucionet Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (përmendur në vijim si “IOAFP”), si dhe garanton zbatimin e proceseve të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e ofertës së arsimit të dyfishtë;

ç) cakton në fillim të çdo viti shkollor strukturat dhe personat përgjegjës për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e arsimit të dyfishtë në IOAFP dhe në mjediset e punës së kompanive trajnuese për arsimin e dyfishtë;

d) raporton përpara bordit drejtues të institucionit në fund të çdo viti shkollor për ecurinë dhe rezultatet e zbatimit të arsimit të dyfishtë;

dh) raporton periodikisht dhe sipas kërkesave në institucionet përgjegjëse për AFP-në për ecurinë dhe rezultatet e zbatimit të arsimit të dyfishtë.

Neni 12

Zëvendës drejtori i kulturës profesionale të institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional

Detyrat e zëvendës drejtorit të kulturës profesionale të AFP-së për zbatimin e arsimit të dyfishtë:

a) planifikon dhe organizon punën me përgjegjësit e departamenteve, njësinë e zhvillimit dhe mësuesin e kulturës profesionale përgjegjës për klasën e arsimit të dyfishtë, për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e punës për mësimin e profesionit të nxënësve punëmarrës, në mjediset e kompanive trajnuese për arsimin e dyfishtë;

b) monitoron procesin e mbarëvajtjes dhe frekuentimit të nxënësit punëmarrës, gjatë punës për mësimin e profesionit, në bashkëpunim me mentorin në kompanitë trajnuese për arsimin e dyfishtë;

c) planifikon dhe organizon punën me përgjegjësit e departamenteve për monitorimin e zbatimit të punës për mësimin e profesionit në kompanitë trajnuese për arsimin e dyfishtë;

ç) raporton periodikisht të drejtori i IOAFP-së, në lidhje me zbatimin e punës për mësimin e profesionit në kompanitë trajnuese për arsimin e dyfishtë;

d) realizon çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtori i IOAFP-së lidhur me koordinimin dhe mbarëvajtjen e punës për mësimin e profesionit në kompanitë trajnuese për arsimin e dyfishtë.

Neni 13

Përgjegjësit e departamentit të drejtimit/profilin mësimor ku ofrohet arsimi në formën e dyfishtë

Përgjegjësi i departamentit në raport me zbatimin e programeve të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë ka këto detyra:

a) monitoron zbatimin e punës për mësimin e profesionit në kompanitë trajnuese për arsimin e dyfishtë, në bazë të raportimeve periodike të bëra nga mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për klasën e arsimit të dyfishtë;

b) monitoron zbatimin e grafikut të realizimit të punës për mësimin e profesionit në kompaninë trajnuese për arsimin e dyfishtë nga mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për klasën e arsimit të dyfishtë dhe kujdestarët e praktikës profesionale;

c) siguron dokumentimin e procesit të punës për mësimin e profesionit nga mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për klasën e arsimit të dyfishtë, përfshirë instrumentet e vlerësimit, fletoren e

frekuentimit të punës nga nxënësit punëmarrës, dosjet personale të nxënësve të realizimit të punës në kompani trajnuese për arsimin e dyfishtë, pajisjen e nxënësve me kartën e shëndetit, librezat shëndetësore etj., sipas kualifikimeve profesionale dhe udhëzimeve në fuqi;

ç) realizon analiza periodike në nivel departamenti, në lidhje me zbatimin e punës për mësimin e profesionit në mjediset e kompanisë trajnuese për arsimin e dyfishtë, dhe raporton periodikisht te nëndrejtori i kulturës profesionale.

Neni 14

Koordinatori për zhvillimin e kurrikulës në institucionin ofrues të arsimit dhe formimit profesional

Koordinatori për zhvillimin e kurrikulës ka këto detyra për zbatimin e arsimit të dyfishtë:

a) koordinon dhe drejton procesin e përshtatjes së vazhdueshme të kurrikulës kombëtare për arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë në nivel ofruesi të AFP-së, me nevojat rajonale të tregut të punës;

b) mbështet mësuesin e kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit në hartimin e planeve të mësimdhënies dhe të instrumenteve të vlerësimit të vazhduar dhe të provimeve përfundimtare të nevojshëm për zbatimin e arsimit të dyfishtë (sipas shtojcës nr. 3, “Fletë vlerësimi nga mentori për kompetencat profesionale dhe personale të nxënësit që mëson profesionin në mjediset e punës”);

c) përgatit një raport për ecurinë dhe problematikat e zbatimit të kurrikulave të arsimit të dyfishtë për njësinë e zhvillimi, përfshirë propozimet përkatëse dhe ia dërgon drejtorit të institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional dhe ky i fundit e dërgon atë në Agjencinë Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Neni 15

Koordinatori për marrëdhëniet me biznesin në institucionin ofrues të arsimit dhe formimit profesional

Koordinatori për marrëdhëniet me biznesin ka këto detyra për zbatimin e arsimit të dyfishtë:

a) studion tregun dhe sipas nevojave, kategorizon dhe përzgjedh punëdhënësit që lidhen me kualifikimet që ofron shkolla;

b) krijon një listë të punëdhënësve potencialë për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit në formën e dyfishtë dhe e ndan atë me mësuesin e kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit;

c) krijon, mirëmban dhe përditëson rregullisht bazën e të dhënave për punëdhënësit që përmbushin kriteret e parapërcaktuara (shtojca nr. 4, “Formular vlerësimi për përmbushjen e kriterëve të punëdhënësit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit”);

ç) dhe e ndan me njësinë e zhvillimit dhe drejtorinë e shkollës;

d) mban kontakt të vazhdueshëm me punëdhënësit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së zbatimit të skeletkurrikulës.

Neni 16

Mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit

Mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, ushtron këto detyra:

a) koordinon planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar të veprimtarive të punës të nxënësve, që mësojnë profesionin në shkollë dhe në vendin e punës;

b) bashkëpunon me stafin drejtues të institucionit, dhe punëdhënësit për përpilimin e programit të veprimtarive për mësimin e profesionit në mjediset e punës (shtojca nr. 5, “Model formati i programit të veprimtarive për mësimin e profesionit në mjediset e punës”);

- c) siguron pajtueshmërinë me ndryshimet legislative të arsimit profesional në formë të dyfishtë dhe integron ndryshimet e reja në aspektet përkatëse të zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit;
- ç) bashkëpunon me punëdhënësit, koordinatorin për marrëdhëniet me biznesin dhe stafin drejtues të institucionit për zbatimin cilësor të veprimtarive në vendin e punës për mësimin e profesionit;
- d) koordinon punën me mentorin për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive për mësimin e profesionit në vendin e punës nga nxënësi që mëson profesionin;
- dh) organizon takime periodike me mentorët dhe punëdhënësit për të shqyrtuar progresin e nxënësve që mësojnë profesionin dhe për të adresuar sfidat e hasura gjatë procesit të të nxënës në vendin e punës;
- e) mban dhe plotëson të gjitha evidencat e përcaktuara në këtë udhëzim për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive për mësimin e profesionit në vendin e punës për mësimin e profesionit (plani i punës, fletorja e vlerësimit etj.);
- ë) ofron këshillim dhe mbështetje për nxënësit që mësojnë profesionin nëse hasin vështirësi në mjedisin e punës, qoftë në aspektin teknik apo në marrëdhëniet me mentorin dhe kolegët;
- f) lehtëson organizimin e vizitave të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve që mësojnë profesionin pranë punëdhënësve, për të rritur transparencën dhe mirëkuptimin për mënyrën se si zbatohet kontrata për mësimin e profesionit;
- g) mbështet pjesëmarrjen e nxënësve që mësojnë profesionin në aktivitete formuese, si: konkurse, panairë apo projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, që kontribuojnë në aftësimin profesional të tyre dhe përgatitjen për tregun e punës, me mirëkuptimin e punëdhënësit;
- gj) harton një raport vjetor për vlerësimin e bashkëpunimit me punëdhënësit;
- h) ngarkesa mësimore e mësuesit të kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi për përcaktimin e ngarkesës mësimore në arsimin dhe formimin profesional dhe përfshin: i. mbulimin për klasën kujdestari; ii. koordinimin, ndjekjen, monitorimin, dokumentimin dhe vlerësimin e veprimtarive të punës për mësimin e profesionit në vendin e punës për mësimin e profesionit; si dhe iii. lëndë/module profesionale të profilit të diplomës që ata zotërojnë.

Neni 17

Kujdestari i praktikës profesionale

1. Kujdestari i praktikës profesionale angazhohet në mbështetje të institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kujdestari i praktikës profesionale ka rol mbështetës dhe këshillues dhe nuk është pjesë e strukturave të brendshme të shkollës.
3. Kujdestari i praktikës profesionale mbështet mësuesin e kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit dhe mentorin gjatë zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.
4. Kujdestari i praktikës profesionale vëzhgon, me dakordësinë e institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional dhe punëdhënësit, ecurinë e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.
5. Kujdestari i praktikës profesionale informon institucionin ofrues të arsimit dhe formimit profesional dhe punëdhënësin për gjetjet gjatë vizitave vëzhguese, si dhe paraqet rekomandime për përmirësim.
6. Kujdestari i praktikës profesionale i raporton drejtuesit të institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional, në mbështetje të së cilës është angazhuar.

Neni 18

Mentori pranë punëdhënësit

Mentori në kompani ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin e skeletkurrikulës nga nxënësi që mësojnë profesionin gjatë kohëzgjatjes së programit profesional të arsimit të dyfishtë:

- a) është përgjegjës për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, për mbarëvajtjen e programit për përfundimin e kualifikimeve nëpërmjet formës së dyfishtë, si dhe për vlerësimin e vazhduar e

përfundimtar të nxënësve që mësojnë profesionin në koordinim e në bashkëpunim me institucionet partnere ofruese të arsimit dhe formimit profesional;

b) duhet të kryejë, jo më vonë se 3 (tre) muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet punëdhënësit dhe institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional për ofrimin e arsimit të dyfishtë, një trajnim për udhëheqjen e nxënësve, që mësojnë profesionin;

c) bashkëpunon me mësuesin e kulturës profesionale, përgjegjës për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, të caktuar nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional;

ç) mban kontakt të rregullt me kujdestarin ligjor të nxënësve që mësojnë profesionin në rastin kur nxënësi nuk e ka mbushur moshën madhore;

d) është përgjegjës për zbatimin e skeletkurrikulës nga nxënësi që mëson profesionin gjatë kohëzgjatjes së kontratës për mësimin e profesionit;

dh) administron rastet kur njëra ose të dyja palët (punëdhënësi dhe nxënësi që mëson profesionin) kanë vendosur të ndërpresin kontratën për mësimin e profesionit.

KREU III

PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I ZBATIMIT TË KONTRATË SË MËSIMIT TË PROFESIONIT NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË FORMËN E DYFISHTË

Neni 19

Përzgjedhja e punëdhënësit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit

1. Institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi, me ata punëdhënësit, të cilat kanë shprehur vullnetin për të ofruar vende vakante pune për mësimin e profesionit, në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë, dhe përmbushin kriteret për t'u përzgjedhur si punëdhënësit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit;

2. Punëdhënësit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit janë publik ose privat. Punëdhënësit publikë të cilat nuk i rregullojnë marrëdhëniet e tyre të punës nëpërmjet ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ose me legjislacionin tjetër të posaçëm në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës mund të ofrojnë vende vakante të punës për mësimin e profesionit për nxënësit që mësojnë profesionin në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë.

3. Punëdhënësit privatë në kuptimin e këtij udhëzimi do të quhen ndërmarrjet që operojnë sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe që mund të ofrojnë vende vakante të punës për mësimin e profesionit për nxënësit që mësojnë profesionin në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë.

4. Punëdhënësi do të konsiderohet i përshtatshëm për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi për ofrimin e vendeve vakante të punës për mësimin e profesionit dhe zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë, nëse përmbush këto kriteret:

a) është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të paktën 3 (tre) vjet dhe operon në përputhje me rregullat e tregut dhe legjislacionin në fuqi, nëse është njësi ekonomike private;

b) ka të paktën 2 (dy) punëmarrës të deklaruar;

c) ushtron veprimtari në fusha që lidhen me kualifikimet/drejtimet/profilet që ofron institucioni ofrues i arsimit dhe formimit profesional;

ç) operon në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të cilin është krijuar, nëse është institucion publik ose me pronësi shtetërore;

d) vetëdeklaron që ka në dispozicion një punëmarrës në rolin e mentorit për ofrimin e kualifikimeve në formën e dyfishtë, i cili plotëson kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi;

dh) vetëdeklaron që është i gatshëm të vendosë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme, si: pajisje, materiale pune dhe vende vakante pune, në funksion të zbatimit të kontratës së punës për mësimin e profesionit;

e) deklaron vendet vakante të punës për mësimin e profesionit;

5. Marrëveshja e bashkëpunimit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë përcakton elementet e mëposhtme:

- a) palët e marrëveshjes;
- b) objektin e marrëveshjes (kualifikimeve profesionale që do të mbulohen);
- c) të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga marrëveshja e bashkëpunimit për ofrimin e arsimit të dyfishtë;
- ç) kohëzgjatjen e marrëveshjes;
- d) kostot, shpenzimet dhe burimet për zbatimin e marrëveshjes;
- dh) ligjin e zbatueshëm dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Neni 20

Të drejtat dhe detyrimet e nxënësit që mëson profesionin

1. Nxënësit e interesuar për t'u regjistruar në kualifikimet e ofruara në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë, duhet të përmbushin të gjitha kriteret dhe të ndjekin procedurat e parashikuara për regjistrimin në arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.

2. Nxënësi, që ka mbushur moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç, i regjistruar në një institucion ofrues të arsimit dhe formimit profesional, në një program për përfitimin e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë, nënshkruan kontratën për mësimin e profesionit me një nga punëdhënësit, që ky institucion ka marrëveshje bashkëpunimi. Kontrata për mësimin e profesionit duhet të jetë në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Punës, si dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve në punë, sipas formatit të përcaktuar me udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

3. Nxënësi përfiton nga punëdhënësi një pagesë për punën e kryer në funksion të mësimin të profesionit, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

4. Nxënësi që mëson profesionin ka të gjitha të drejtat e detyrimet ligjore si çdo nxënës, në përputhje me legjislacionin për arsimin dhe formimin profesional.

5. Nxënësit që mësojnë profesionin, që nuk e kanë mbushur moshën madhore, gëzojnë mbrojtjen ligjore, që gëzon çdo nxënës e çdo fëmijë që punon në Republikën e Shqipërisë.

6. Nxënësi që mëson profesionin ka të drejtën për pushime vjetore të paguara, si dhe për pushime të tjera me apo pa pagesë në përputhje me Kodin e Punës dhe kontratën e punës për mësimin e profesionit.

7. Nxënësi që mëson profesionin, dhe që ka mbushur 16 vjeç, për nënshkrimin e kontratës për mësimin e profesionit duhet të posedojë paraprakisht:

- a) letërnjoftim;
- b) raport mjekoligjor për vërtetimin e aftësisë në punë;
- c) deklaratë të prindit/kujdestarit ligjor për lidhjen e kontratës për mësimin e profesionit;
- ç) vërtetim të llogaritë bankare personale;
- d) librezë shëndetësore.

8. Nxënësi që mëson profesionin informohet paraprakisht për:

a) punëdhënësit që kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e kontratës së punës për mësimin e profesionit me institucionet e arsimit dhe formimit profesional, përkatëse dhe që përputhen me profilin/drejtimin që ata kanë zgjedhur;

b) vendet vakante të punës për mësimin e profesionit, për nxënësit që mësojnë profesionin të shpallura nga punëdhënësit;

c) modalitetet kryesore të intervistës së punës.

Neni 21

Rekrutimi i nxënësve që mësojnë profesionin nga punëdhënësit për zbatimin e kontratës së punës për mësimin e profesionit

1. Rekrutimi i nxënësve që mësojnë profesionin nga punëdhënësit që zbatojnë kontratën për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë bëhet nëpërmjet këtyre fazave:

a) punëdhënësi që zbaton kontratën për mësimin e profesionit nëpërmjet arsimit në formën e dyfishtë shpall vendet vakante të punës për mësimin e profesionit;

b) nxënësi që mëson profesionin aplikon për vendin vakant të punës për mësimin e profesionit të shpallur nga punëdhënësi nëpërmjet jetëshkrimit – CV-së (shtojca nr. 6, “Model CV-je”);

c) punëdhënësi organizon intervistën e punës me nxënësit që kanë aplikuar për vendet vakante të punës për mësimin e profesionit;

ç) punëdhënësi përzgjedh nxënësit për vendet vakante të punës për mësimin e profesionit të deklaruar dhe palët nënshkruajnë kontratën për mësimin e profesionit.

2. Intervista e punës së nxënësit që mëson profesionin bëhet në mjediset e institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional ose në mjediset e punës së punëdhënësit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit. Intervista e punës duhet t’u përmbahet këtyre parimeve:

a) parimit të mosdiskriminimit;

b) parimit të shanseve të barabarta;

c) parimit të transparencës.

3. Kontrata tip për mësimin e profesionit, parashikon të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 22

Kushtet dhe kohëzgjatja e periudhës së punës për mësimin e profesionit

1. Kontrata për mësimin e profesionit hyn në fuqi jo më herët se dita e parë e vitit shkollor për kualifikimin profesional përkatës dhe zgjat deri në momentin kur nxënësi që mëson profesionin i nënshtrohet provimit të nivelit për kualifikimin profesional përkatës i ofruar në formën e dyfishtë.

2. Në përfundim të programit të studimit, nxënësi që mëson profesionin pajiset me certifikatën profesionale dhe suplementin përkatës nga institucioni ofrues i arsimit dhe i formimit profesional, si dhe me një vërtetim/letër reference në fund të realizimit me sukses të kontratës për mësimin e profesionit nga punëdhënësi përkatës.

3. Kushtet e punës së nxënësit që mëson profesionin përshtaten me moshën e tij. Punëdhënësi nuk i propozon nxënësit që mëson profesionin asnjë veprimtari pune e cila ka një natyrë që mund të dëmtojë shëndetin e tij apo zhvillimin e tij fizik, psikologjik, social, moral apo të ndikojë në ecurinë e shkollimit.

4. Orët ditore të veprimtarive të punës për mësimin e profesionit në mjediset e punës për mësimin e profesionit, për nxënësit që mësojnë profesionin për moshën 16–18 vjeç do të zhvillohen në përputhje me “Rregulloren për mbrojtjen e fëmijëve në punë”, miratuar me VKM-në nr. 108, datë 15.2.2017, dhe nuk mund të jenë më shumë se 30 orë në javë dhe më shumë se 6 orë në ditë të barasvlershme me 8 orë mësimore.

5. Orët ditore të veprimtarive të punës për mësimin e profesionit, në mjediset e punës për mësimin e profesionit, për nxënësit që mësojnë profesionin, pas moshës 18 vjeç, do të jenë 8 orë në ditë dhe jo më shumë se 40 orë në javë.

6. Për të llogaritur vëllimin mësimor gjatë veprimtarive të punës për mësimin e profesionit merret në konsideratë fakti që 6 orë pune (1 orë pune = 60 minuta) në vendin e punës për mësimin e profesionit janë të barasvlershme me 8 orë mësimore (1 orë mësimore = 45 minuta) si dhe 8 orë pune (1 orë pune = 60 minuta) në vendin e punës për mësimin e profesionit janë të barasvlershme me 10 orë mësimore (1 orë mësimore = 45 minuta).

7. Gjatë zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit pushimet vjetore dhe pushimet e tjera do të rregullohen në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Punës dhe kontratën për mësimin e profesionit.

8. Kohëzgjatja dhe periudha e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit për arsimin e dyfishtë përcaktohet në skeletkurrikulën e kualifikimeve të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë.

KREU IV

PËRGATITJA DHE PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE TË PUNËS DHE ZBATIMI I KONTRATËS PËR MËSIMIN E PROFESIONIT

Neni 23

Programi i përgjithshëm i veprimtarive për mësimin e profesionit në mjediset e punës

1. Programi i veprimtarive për mësimin e profesionit në mjediset e punës është specifik sipas kualifikimit përkatës, në përputhje me skeletkurrikulën dhe hartohet nga institucioni ofrues i arsimit dhe i formimit profesional në bashkëpunim me mentorin, sipas formatit të përcaktuar në këtë rregullore. (Shtojca nr. 7, “Format për programin e përgjithshëm i veprimtarive për mësimin e profesionit në mjediset e punës”).

2. Mësuesi i kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, në bashkëpunim me mentorin, përcaktojnë numrin e nxënësve që mësojnë profesionin, në vendin e punës, periudhën kohore, si dhe vëllimin e kohës së zhvillimit të veprimtarive për mësimin e profesionit, në varësi të kushteve të nevojshme për të nxënë në mjedisin e punës.

Neni 24

Monitorimi i veprimtarive të punës për mësimin e profesionit

1. Mentori, së bashku me mësuesin e kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, planifikon procesin e zbatimit të veprimtarive praktike në vendin e punës për mësimin e profesionit, si dhe vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin përfundimtar të nxënësve që mësojnë profesionin.

2. Mësuesi i kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, në bashkëpunim të ngushtë me mentorin monitoron ecurinë e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, në vendin e punës.

3. Mësuesi i kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, në bashkëpunim me mentorin, monitoron frekuentimin për çdo nxënës që mëson profesionin gjatë punës për mësimin e profesionit dhe e pasqyron këtë në dokumentacionin shkollor.

Neni 25

Portofoli i veprimtarive të punës për mësimin e profesionit

1. Gjatë veprimtarive të punës për mësimin e profesionit, në mjediset e punës, nxënësi që mëson profesionin, pasqyron rregullisht në fletoren përkatëse:

- a) detyrat dhe veprimtaritë e kryera;
- b) kompetencat profesionale e personale të përvetësuara; si dhe
- c) proceset dhe/ose teknologjitë me të cilat është njohur gjatë zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit (shtojca nr. 8, “Portofoli i veprimtarive të punës të nxënësit që mëson profesionin në mjedisin e punës”).

2. Portofoli i veprimtarive praktike të punës për mësimin e profesionit të nxënësit që mëson profesionin përmban:

- a) fletoren e praktikës së punës;
- b) shembuj me evidenca gjatë zbatimit të veprimtarive të punës sipas planit mësimor të punës;
- c) raportin me reflektime konkrete gjatë praktikës në punë, me përvojat më të spikatura dhe vështirësitë kryesore.

3. Fletorja e praktikës së punës kontrollohet rregullisht dhe nënshkruhet nga mentori dhe mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.

Neni 26

Vlerësimi i vazhduar i nxënësit gjatë veprimtarive për mësimin e profesionit në vendin e punës

1. Vlerësimi i arritjeve të nxënësit që mëson profesionin, gjatë punës për mësimin e profesionit, bëhet me notë për çdo veprimtari mësimore, bazuar në instrumentet e vlerësimit të dakordësuar midis mentorit dhe mësuesit të kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.

2. Vlerësimi i vazhduar i punës në zbatim të kontratës për mësimin e profesionit bazohet në:

- a) portofolin e praktikës së veprimtarive të punës të nxënësit që mëson profesionin;
- b) listën e detyrave që duhet të përmbushë nxënësi në mjediset e punës;
- c) dokumentimin dhe raportimin nga procesi i monitorimit.

3. Vlerësimi i vazhduar i veprimtarive praktike në mjediset e punës për mësimin e profesionit është përgjegjësi e mentorit në bashkëpunim me mësuesin e kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.

4. Mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit pasqyron në dokumentacionin shkollor rezultatet e vlerësimit të vazhduar të punës së nxënësve që mësojnë profesionin në vendin e punës.

5. Për vlerësimin e vazhduar të nxënësit që mëson profesionin, mentori përdor instrumente të dakordësuara me mësuesin e kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.

Neni 27

Transferimi i nxënësit që mëson profesionin nga njëri punëdhënës tek tjetri

1. Nxënësi që mëson profesionin, kanë të drejtë të transferohen nga një punëdhënës që zbaton kontratën e mësimin të profesionit në formën e dyfishtë në një tjetër, si dhe nga një program për përfitimin e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë në një program me bazë shkolle brenda të njëjtit kualifikim.

2. Nxënësi që mëson profesionin, i cili ngre pretendimin që punëdhënësi për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, dhe anasjelltas, nuk përmbush cilësitë apo pritshmëritë mbi marrëdhënien në përputhje me kontratën për mësimin e profesionit, kërkon zgjidhjen e kontratës.

3. Mentori koordinon procesin e zgjidhjes së kontratës për mësimin e profesionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe njofton institucionin ofrues të arsimit dhe formimit profesional, përgjegjëse për nxënësin që mëson profesionin.

4. Institucioni i arsimit dhe formimit profesional përgjegjës, i cili merr dijeni për zgjidhjen e kontratës për mësimin e profesionit përpara afatit të parashikuar, i paraqet kandidaturën e nxënësit që mëson profesionin, punëdhënësve të tjerë me të cilët ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit dhe që kanë vende vakante të punës për mësimin e profesionit.

5. Institucioni i arsimit dhe i formimit profesional monitoron procesin e transferimit të nxënësit që mëson profesionin, nga njëri punëdhënës tek tjetri.

6. Në rast kur nuk gjendet një punëdhënës tjetër, për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, institucioni ofrues i arsimit dhe formimit profesional bën kalimin e nxënësit që mëson profesionin në arsimin në bazë shkolle.

7. Transferimi bëhet brenda shkollës ose nga një shkollë tjetër, sipas procedurave të udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruese të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

KREU V

VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR DHE CERTIFIKIMI I NXËNËSVE QË MËSOJNË PROFESIONIN

Neni 28

Vlerësimi përfundimtar dhe certifikimi i nxënësit që mëson profesionin

1. Vlerësimi përfundimtar i punës për mësimin e profesionit, të nxënësit që mëson profesionin është vlerësimi me notë që kryhet në përfundim të veprimtarive të punës, i llogaritur si mesatare e ponderuar e vlerësimeve (notave) të fituara gjatë vlerësimit të vazhduar për çdo kompetencë profesionale dhe personale, që përmbahet në program.

2. Institucioni ofrues i arsimit dhe formimit profesional angazhon punëdhënësit që zbatojnë kontratën për mësimin e profesionit dhe mentorin, që ka ndjekur nxënësin gjatë zbatimit të kontratës

për mësimin e profesionit, në komisionet e vlerësimit në provimet përfundimtare të praktikës profesionale për çdo kualifikim profesional sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

3. Në përfundim të studimeve, sipas niveleve të KSHK-së, në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë, institucioni ofrues i arsimit dhe i formimit profesional lëshon certifikatë profesionale dhe suplementin përkatës për nxënësin që mëson profesionin sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 29

Vërtetimi i lëshuar nga punëdhënësi

Punëdhënësi, në fund të realizmit me sukses të kontratës për mësimin e profesionit, lëshon një vërtetim/letër referencë për njohjen e punës së bërë nga nxënësi që mëson profesionin vendin e punës. (Shtojca nr. 9, “Model vërtetim/letër reference”).

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30

Zbatimi dhe hyrja në fuqi

1. Në udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, shfuqizohen: në nenin 7: pikat 5, 6, 8, 9 dhe 11; në nenin 11: pika 4 dhe 5; në nenin 16: pika 3; në nenin 17: pika 4; në nenin 18: pika 5; në nenin 25: pika 4, 5 dhe 6; në nenin 27: pika 8; në nenin 29: pikat 9, 10 dhe 11; në nenin 43: pika 5 dhe 6; në nenin 75: pika 3; në nenin 76: pika 3; në nenin 96: pika 4; në nenin 102: shkronjat: “b”, “d” dhe “g”; në nenin 103: shkronjat “e”, “g” dhe “j”; në nenin 111: pika 2, germa “c”).

2. Në udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, shfuqizohen të gjitha nenet e kreut X, “Zbatimi i programeve të arsimit të dyfishtë”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, drejtoria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, si institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, që ofrojnë arsim dhe formim profesional në formën e dyfishtë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

SHTOJCAT

SHTOJCA NR. 1

Model

Kontratë për mësimin e profesionit

Sot, më datë __. __. __, lidhet kontrata për mësimin e profesionit (këtu e në vijim “kontrata”) ndërmjet Palëve:

“[●]”, me seli në adresën: [●], me NUIS [●], përfaqësuar ligjërisht nga z./znj. [●], (këtu e në vijim “punëdhënësi”),

z./znj. [●], (*emër, mbiemër*), i biri/e bija e [●], lindur më [●], në [●], me adresë në: [●], mbajtës/e i/e letërnjoftimit/kartës së identitetit nr. [●] (këtu e në vijim “nxënësi që mëson profesionin”).

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë sipas kushteve të përcaktuara këtu më poshtë:

Neni 1 Baza ligjore

Kjo kontratë bazohet në nenet 17, 18 dhe 113 pika 3 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 16, pika 3/“c” e ligjit nr. 15/17, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në VKM-në nr. 691, datë 6.11.2024, “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimit të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë”.

Neni 2 Objekti

Kjo kontratë ka për objekt rregullimin e marrëdhënies midis palëve, për zbatimin e veprimtarive të punës për nxënësin që mëson profesionin, në kualifikimin [●] e nivelit [●] të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, e ofruar nëpërmjet formës së dyfishtë të arsimit dhe formimit profesional.

Neni 3 Pozicioni dhe vendi i punës

1. Nxënësi që mëson profesionin, ushtron detyrën e [●], në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate dhe objektivat e dakordësuar, sipas programit të skeletkurrikulës përkatëse në aneksin 1 të kësaj kontrate.

2. Vendi i punës për mësimin e profesionit ndodhet në adresën: [●].

Neni 4 Kohëzgjatja e kontratës

1. Kjo kontratë do të këtë një kohëzgjatje prej [●] muajsh e cila do të fillojë me datë [●] dhe do të përfundojë më datë [●].

2. Puna për mësimin e profesionit do të kryhet në vazhdimësi gjatë gjithë periudhës së sipërpërmendur, si brenda, ashtu dhe jashtë periudhës shkollore.

Neni 5 Oraret e punës për mësimin e profesionit

1. Ditët dhe oraret e punës në vendin e punës për mësimin e profesionit përcaktohen dhe vendosen nga punëdhënësi dhe nxënësi që mëson profesionin, në përputhje me orarin mësimor në IOAFP dhe në vendin e punës për mësimin e profesionit, sipas aneksit 2 të kësaj kontrate.

2. Në çdo rast, kohëzgjatja ditore dhe javore e punës për nxënësin që mëson profesionin të moshës 16–18 vjeç vendoset në përputhje me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve në Punë¹, e cila nuk mund të jetë më shumë se 6 orë në ditë dhe më shumë se 30 orë në javë.

Neni 6 Pagesa mujore

1. Pagesa mujore e nxënësit që mëson profesionin është [●] lekë [plotëso shumën me fjalë].

¹ Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 15.2.2017, “Për miratimin e rregullores ‘Për mbrojtjen e fëmijëve në punë’”, të ndryshuar.

2. Pagesa i paguhet nxënësit që mëson profesionin nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë bankare të nxënësit brenda 10 (dhjetë) ditëve të muajit pasardhës.

3. Pagesa përfshin kontributet në nivelin minimal, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, në vlerën 0,3% të pagës minimale në shkallë vendi.

Neni 7

Përfitime shtesë për nxënësin që mëson profesionin

Punëdhënësi rezervon të drejtën t'i sigurojë nxënësit që mëson profesionin përfitime shtesë, të cilat punëdhënësi i vlerëson lirisht kohë pas kohe. Këto përfitime shtesë konsiderohen përfitime vullnetare nga punëdhënësi dhe ky i fundit rezervon të drejtën që, në mënyrë të njëanshme, t'i rishikojë dhe revokojë këto përfitime sipas gjykimit të tij të vetëm pa njoftim paraprak. Në këtë drejtim, dhënia e këtyre përfitimeve shtesë nuk do të konsiderohet detyrim i përhershëm i punëdhënësit.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

1. Punëdhënësi, merr përsipër të kryejë sa më poshtë:

a) Të caktojë një anëtar të stafit si mentori, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe që është përgjegjës për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, për mbarrëvajtjen e programit për përfitim të kualifikimeve nëpërmjet formës së dyfishtë, si dhe për vlerësimin e vazhduar e përfundimtar të nxënësve që mësojnë profesionin në koordinim e në bashkëpunim me mësuesin e kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit të IOAFP-së me të cilën është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

b) Të vlerësojë risqet specifike lidhur me zhvillimin mendor dhe fizik të nxënësit që mëson profesionin dhe në përputhje me risqet e konstatuara, të miratojë masat e nevojshme për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e tij/saj. Ky vlerësim kryhet nga punëdhënësi përpara se nxënësi që mëson profesionin të fillojë veprimtaritë përkatëse për mësimin e profesionit, ose në rastet e ndryshimeve madhore të kushteve të punës. Në mënyrë të veçantë, ky vlerësim ka të bëjë me:

- i. strukturën dhe organizimin e vendit dhe të pozicionit të punës;
- ii. natyrën, shkallën dhe kohëzgjatjen e ekspozimit ndaj agentëve fizikë, biologjikë dhe kimikë;
- iii. formën, gamën dhe përdorimin e pajisjeve të punës, në veçanti, agentëve, makinerive, aparaturave e pajisjeve dhe mënyrën me të cilën ato manipulohen;
- iv. organizimin e proceseve të punës, funksionimin dhe mënyrën me të cilën ato kombinohen;
- v. nivelin e trajnimit dhe udhëzimeve të dhëna nxënësit që mëson profesionin.

c) T'i sigurojë nxënësit që mëson profesionin, të rekrutuar sipas procedurave ligjore në fuqi, vendin e punës, mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për të mësuar në vendin e punës.

d) T'i sigurojë nxënësit që mëson profesionin kushte pune që përshtaten me moshën e tij/saj dhe të mos i propozojë asnjë veprimtari pune e cila ka një natyrë e cila mund të dëmtojë shëndetin e tij apo zhvillimin e tij fizik, psikologjik, social, moral apo të ndikojë në ecurinë e shkollimit të tij.

e) Të ofrojë sigurinë dhe mbrojtjen në punë dhe kushtet higjienike për nxënësin që mëson profesionin.

f) Të informojë nxënësin që mëson profesionin për rregullat e sigurimit teknik, bazuar në legjislacionin në fuqi.

g) Të përcaktojë shërbime mbrojtëse dhe parandaluese për qëllim të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të sigurisë dhe shëndetit të nxënësit që mëson profesionin. Nëse vlerësimi i riskut tregon se ekziston një risk për sigurinë, zhvillimin e nxënësit që mëson profesionin, shëndetin fizik ose mendor, punëdhënësi siguron një vlerësim dhe monitorim të përshtatshëm, pa pagesë, të shëndetit të nxënësit që mëson profesionin, në intervale të rregullta. Gjithashtu, punëdhënësi informon nxënësin që mëson profesionin për risqet e mundshme dhe masat e miratuara për shëndetin dhe sigurinë e tyre.

h) Të sigurojë mbikëqyrje të plotë shëndetësore për nxënësin që mëson profesionin, të përshtatur dhe në bazë të risqeve të lidhura me formimin profesional të kryer sipas kësaj kontrate, duke mbuluar

shpenzimet për kontrollet periodike mjekësore të nxënësit që mëson profesionin dhe siguron ruajtjen e konfidencialitetit për çdo të dhënë personale që lidhet me gjendjen e tyre.

i) Të udhëzojë nxënësin që mëson profesionin dhe ta vendosë atë në role të ndryshme në kompani për kualifikimin e tij profesional brenda saj, sipas programit të shtojcës 1 bashkëngjitur kësaj Kontrate.

j) T'i sigurojë nxënësit që mëson profesionin pushime vjetore të paguara në përputhje me Kodin e Punës.

k) T'i sigurojë nxënësit të moshës 16–18 vjeç që mëson profesionin pushime për çlodhje, në përputhje me “Rregulloren për mbrojtjen e fëmijëve në punë”, miratuar nga VKM-ja nr. 108, datë 15.2.2017, ku periudha minimale është 30 minuta të pandërprera për veprimtari për mësimin e profesionit që zgjat më shumë se 4 orë e gjysmë.

l) T'i sigurojë nxënësit të moshës 16–18 vjeç që mëson profesionin, për çdo periudhë 24-orëshe, një periudhë minimale çlodhjeje prej 12 orësh të pandërprera.

m) T'i sigurojë nxënësit të moshës 16–18 vjeç, që mëson profesionin të paktën 2 ditë radhazi për çlodhje brenda periudhës 7-ditore. Kur justifikohet nga shkaqe teknike ose organizative, periudha minimale e çlodhjes mund të reduktohet, por në asnjë rrethanë nuk mund të jetë më pak se 36 orë rresht. Periudha minimale e çlodhjes përfshin, në parim, të shtunën dhe të dielën.

2. Nxënësi që mëson profesionin gëzon të drejtat e merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

a) Nxënësi që mëson profesionin ka të drejtë të informohet nga mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës së mësimin të profesionit, dhe mentori, për të drejtat dhe detyrimet sipas moshës së tij/së saj dhe në përputhje me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve në Punë.

b) Nxënësi që mëson profesionin, duhet të paraqesë, përpara fillimit të kontratës për mësimin e profesionit, raportin e mjekut të familjes, ku deklarohet aftësia e tij/saj për punë.

c) Nxënësi që mëson profesionin është i/e detyruar të respektojë orarin e punës së vendosur nga punëdhënësi dhe të respektojë disiplinën në punë, sipas rregullave dhe udhëzimeve të brendshme të punëdhënësit.

d) Nxënësi që mëson profesionin i kryen detyrat personalisht duke ndjekur udhëzimet e ligjshme dhe të arsyeshme të mentorit.

e) Nxënësi që mëson profesionin do të zbatojë politikat dhe procedurat e përcaktuara nga IOAFP-ja ose që IOAFP-ja mund të përcaktojë në lidhje me nxënësin që mëson profesionin gjatë kohëzgjatjes së kontratës për mësimin e profesionit.

f) Nxënësi që mëson profesionin do të zbatojë në çdo kohë legjislacionin, kodet e etikës ose udhëzimet e aplikueshme të çdo forme.

g) Nxënësi që mëson profesionin do të mbrojë interesat e punëdhënësit ku mëson profesionin dhe do të shmangë çdo dëm të mundshëm ndaj tij.

h) Nxënësi që mëson profesionin detyrohet t'i përdorë pajisjet dhe mjetet e siguruara nga punëdhënësi që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij/saj sipas kësaj kontrate dhe në zbatim të plotë të procedurave apo rregullave të brendshme të punëdhënësit. Me përfundimin e kontratës, ai/ajo do t'i kthejë menjëherë këto pajisje apo mjete punëdhënësit.

i) Nxënësi që mëson profesionin duhet të respektojë rregullat e sigurimit teknik të punëdhënësit, në përputhje me rregullat e brendshme të etikës në punë, specifikat e pozicionit të punës për mësimin e profesionit, si dhe rregullat për mbrojtjen e mjedisit.

j) Nxënësi që mëson profesionin duhet të informojë menjëherë IOAFP-në dhe/ose punëdhënësin në rast mungese në orët e përcaktuara për mësimin e profesionit të punëdhënësi.

k) Nxënësi që mëson profesionin zbaton udhëzimet e mentorit, kryen me përgjegjësi punët që i caktohen dhe respekton pronësinë intelektuale të punëdhënësit.

l) Në çdo kohë, përfshirë periudhën pas përfundimit të kontratës për mësimin e profesionit, nxënësi që mëson profesionin bie dakord dhe pranon, se:

i. do të ruajë sekret çdo informacion konfidencial të punëdhënësit, për të cilin ai merr dijeni apo zotëron gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate dhe nënshkruan Deklaratën e Konfidencialitetit, sipas aneksit 3;

ii. të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të zhvilluara nga nxënësi që mëson profesionin gjatë kohës së zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, sipas kësaj kontrate do t'i kalojnë dhe do të ushtrohen nga punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme sapo të krijohen;

iii. punëdhënësi ushtron dhe zotëron në çdo kohë të gjitha të drejtat e lidhura me pronësinë e saj intelektuale;

iv. asgjë në këtë kontratë, përfshirë dhe përmbushjen e detyrimeve të nxënësit që mëson profesionin sipas kësaj kontrate, nuk do të interpretohet si dhënie ose shkak për ngritjen e pretendimeve në lidhje me të drejtat pronësore ose interesave nga ana e nxënësit që mëson profesionin në lidhje me punët ose të drejtat e pronësisë intelektuale të punëdhënësit.

n) Nxënësi që mëson profesionin do të nënshkruajë çdo dokument dhe do të kryejë çdo veprim që është i nevojshëm ose i kërkuar me qëllim zbatimin e kësaj dispozite.

Neni 9

Vërtetim për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit

1. Në fund të periudhës së kontratës për mësimin e profesionit, punëdhënësi do të lëshojë një vërtetim/letër reference për nxënësin që mëson profesionin, duke përfshirë kohën e zbatimit të kontratës, pozicionin e punës dhe vlerësimin e punëdhënësit për nxënësin.

2. Forma e vërtetimit do të përcaktohet nga kompania. Ky vërtetim do të nënshkruhet nga titullari i kompanisë dhe do të mbajë vulën zyrtare të kësaj të fundit.

Neni 10

Sigurimi nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale

Në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, nxënësi që mëson profesionin konsiderohet i/e mbrojtur dhe përfiton të ardhura e shërbime nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, të cilat do të paguhet nga punëdhënësi në vlerën 0.3% e pagës minimale në shkallë vendi.

Neni 11

Kushtet e punës dhe mbrojtja në punë

Punëdhënësi merr përsipër të sigurojë kushte normale për kryerjen e punës, në mënyrë që punëmarrësit të mos i dëmtohet shëndeti dhe jeta.

Neni 12

Shpenzimet për mësimin e profesionit

1. Punëdhënësi merr përsipër shpenzimet që lidhen me angazhimin e mentorit; pajisjet dhe materialet e konsumit që vihen në dispozicion të nxënësit që mëson profesionin, si dhe pagën minimale për mësimin e profesionit.

2. Nëse punëdhënësi ofron për punëmarrësit e saj përfitime të tjera, si shpenzimet e transportit apo të ushqimit gjatë orarit të punës për punonjësit e tjerë, ajo do t'i ofrojë ato në të njëjtën mënyrë për nxënësin që mëson profesionin. Në këtë rast, palët do të bien dakord me shkrim për përfitimet konkrete të ofruara prej punëdhënësit.

Neni 13

Zgjidhja e kontratës

1. Secila prej palëve ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

2. Zgjidhja e kontratës për mësimin e profesionit bëhet e menjëhershme me mbarimin e kohës së caktuar në kontratë.

3. Pas përfundimit të afatit të kontratës në çdo kohë punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e punës, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në nenin 144 të Kodit të Punës.

4. Kjo marrëveshje mund të zgjidhet prej punëdhënësit, në rastet e mëposhtme:

- a) nxënësi që mëson profesionin shkel detyrimet e kësaj kontrate, me faj të rëndë, ose me faj të lehtë të përsëritur me gjithë paralajmërimet e punëdhënësit;
 - b) nxënësi që mëson profesionin nuk zbaton rregulloren e brendshme të funksionimit të punëdhënësit dhe shkel në mënyrë të përsëritur kodin e etikës, disiplinën e mësimi apo praktikës, me gjithë paralajmërimet e mentorit;
 - c) në rast se shkel në mënyrë të përsëritur orarin e punës, me gjithë paralajmërimet qoftë edhe verbale të punëdhënësit;
 - d) kur nxënësi që mëson profesionin dëmton apo keqpërdoron pronën e punëdhënësit apo ka sjellje të padenjë në mënyrë të përsëritur pavarësisht vërejtjeve të dhëna nga punëdhënësi;
 - e) kur provohet se nxënësi që mëson profesionin nxjerr të dhëna konfidenciale të kompanisë.
5. Kjo kontratë mund të zgjidhet prej nxënësit që mëson profesionin, në rast se punëdhënësi dhe/ose mentorin shkelin një/disa prej të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë.

Neni 14

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo kontratë bazohet në ligjin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i saj do të kryhet dhe zbatohet përkatësisht.
2. Në rast mosmarrëveshje të cilat lindin në lidhje me ose si pasojë e interpretimit ose zbatimit të kësaj kontrate dhe të cilat nuk zgjidhen me mirëkuptim midis palëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm [●].

Neni 15

Dispozita të fundit

1. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis palëve për sa i përket objektit të saj dhe ka përparësi ndaj çdo marrëveshje të mëparshme me shkrim ose me gojë, të shprehur ose të heshtur. Ajo mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim midis palëve.
2. Shtojcat e mëposhtme bashkëngjitur kësaj marrëveshje janë pjesë përbërëse e saj:
 - a) **aneksi 1**, “Programi i veprimtarive për mësimin e profesionit në zbatim të skeletkurrikulës së kualifikimit profesional [●] të zbatuar në mjediset e punës për mësimin e profesionit; **aneksi 2**, “Orari mësimor në IOAFP dhe te punëdhënësi në zbatim të skeletkurrikulës së kualifikimit profesional [●] të zbatuar në mjediset e punës për mësimin e profesionit”; **c) aneksi 3**, “Deklaratë konfidencialiteti”.
3. Kjo kontratë hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, secila me të njëjtën vlerë, nga të cilat një kopje e mban punëdhënësi dhe një kopje e mban nxënësi që mëson profesionin.

PALËT

Punëdhënësi
“[●]”

Përfaqësuar nga

Nxënësi që mëson profesionin
“[●]”

ANEKS 1

PROGRAMI I VEPRIMTARIVE PËR MËSIMIN E PROFESIONIT

Në zbatim të skeletkurrikulës së kualifikimit profesional [●] të zbatuar në mjediset e punës për mësimin e profesionit

ANEKS 2 ORARI MËSIMOR

Në IOAFP dhe punëdhënës në zbatim të skeletkurrikulës së kualifikimit profesional [●] në mjediset e punës për mësimin e profesionit

ANEKS 3 DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Objekti

Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga të gjithë nxënësit që mësojnë profesionin të cilët nënshkruajnë një kontratë për mësimin e profesionit pranë punëdhënësit dhe kanë akses në të dhënat personale të punëdhënësit. Deklarata është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Qëllimi

Ajo përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Fusha e veprimit

Fushëveprimi i kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat personale dhe informacione konfidenciale që njihen gjatë formimit profesional pranë punëdhënësit. Dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi formimi profesional pranë punëdhënësit ka përfunduar.

Deklarata e konfidencialitetit

1. Me anë të kësaj deklarate, marr përsipër të mos përdor dhe të mos u transmetoj personave të paaautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale, në lidhje me, ose të marra nga punëdhënësi, përveç nëse autorizohem shprehimisht nga punëdhënësi, ose kur kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të formimit profesional, si dhe pas përfundimit të tij.

2. Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga ligji nr. 9987, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë formimit profesional për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e tij.

3. Unë e kuptoj se jam i/e detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.

4. Marr përgjegjësinë e plotë, që në qoftë se konstatohet që kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale, apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të mbajtur standarde të larta profesionale në kompani.

Punëdhënësi

Nxënësi që mëson profesionin

SHTOJCA NR. 2

Marrëveshje bashkëpunimi për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë

Sot, më datë __.__.__, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Institucioni Ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional (IOAFP) _____,
me adresë: _____ përfaqësuar ligjërisht nga
znj/ z. _____ (këtu e në vijim “Shkolla”).

Punëdhënësi _____, me adresë: _____,
përfaqësuar ligjërisht nga: znj/z. _____, në cilësinë e _____ (këtu e në
vijim “Punëdhënësi”).

Palëve u referohemi individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”. Palët kanë interesa të përbashkët dhe bien dakord të bashkëpunojnë në fushën e ofrimit të arsimit dhe formimit profesional të formës së dyfishtë, bazuar në përfitime të njëjta dhe reciproke.

Palët synojnë të përcaktojnë qëllimet kryesore, objektivat, fushat dhe format e bashkëpunimit të përfshira në këtë marrëveshje bashkëpunimi për sa vijon:

Neni 1 Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në nenet 17, 18 dhe 113, pika 3, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 16, pika 3/“c”, e ligjit nr. 15/17, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe në VKM-në nr. 691, datë 6.11.2024, “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimin të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë”.

Neni 2 Qëllimi dhe objekti

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve, nënshkruhet në kuadër të ofrimit të kualifikimeve profesionale në formën e dyfishtë dhe shpreh vullnetin e palëve për zbatimin e rregullave, kritereve dhe procedurave për ofrimin e programeve të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë.

2. Palët dakordësojnë mbi zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, në vendin e punës, në përputhje me parashikimet e skeletkurrikulës së programit përkatës.

3. Marrëveshja e bashkëpunimit nuk ka për qëllim të krijojë, mbajë ose imponojë të drejta dhe detyrime ligjore ndaj Palëve ose ndërmjet Palëve të treta.

4. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi nga Palët e përcaktuara në të, u nënshtrohet përcaktimeve ligjore në fuqi.

5. Bashkëlidhur kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të vendoset:

a) Skeletkurrikula e programit profesional të studimit ku do të përcaktohet qartë emërtimi i profesionit, kohëzgjatja e programit, kompetencat që do të fitohen përmes veprimtarive dhe ofrimit të moduleve profesionale në kompani (aneks I);

b) Formulari i vlerësimit për përmbushjen e kritereve të punëdhënësit dhe relacioni për inspektimin e vendit të punës dhe kapaciteteve infrastrukturore të punëdhënësit për ofrimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë (aneks II).

Neni 3 Angazhimet e palëve

1. Përgjegjësitë e punëdhënësit:

a) të nënshkruajë dhe të garantojë zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit me nxënësin që mëson profesionin;

b) të sigurojë vendin e punës, mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme, si: pajisje dhe materiale pune për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, për çdo nxënës që mëson profesionin (aneks II);

c) të organizojë punën për mësimin e profesionit në mënyrë fleksibël dhe në përputhje me orarin mësimor të nxënësit që mëson profesionin;

d) t'i paguajë një pagesë mujore nxënësit që mëson profesionin për punën, që kryen gjatë mësimit të profesionit, sipas legjislacionit në fuqi;

e) të caktojë një anëtar të stafit si mentor, i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, mbarëvajtjen e programit për përfitimin e kualifikimeve nëpërmjet formës së dyfishtë, si dhe vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar të nxënësve që mësojnë profesionin në koordinim e në bashkëpunim me shkollën;

f) të mbajë kontakt të rregullt përmes mentorit, me kujdestarin ligjor të nxënësve që mësojnë profesionin, në rastin kur nxënësi nuk e ka mbushur moshën madhore;

g) të certifikojë nxënësit që mësojnë profesionin për rregullat e sigurimit teknik në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

h) të dokumentojë realizimin e kontratës dhe kryejë vlerësimin e nxënësit që mëson profesionin përgjatë punës për mësimin e profesionit;

i) të lëshojnë vërtetim/letër reference në fund të realizimit me sukses të kontratës për mësimin e profesionit;

j) të zbatojë dispozitat ligjore, të cilat rregullojnë punën e punëmarrësit të grup-moshës 16 (gjashtëmbëdhjetë) deri në 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, si dhe dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve në punë, në rastet kur nxënësi që mëson profesionin nuk ka mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç në momentin e nënshkrimit të kontratës.

2. Përgjegjësitë e IOAFP-së:

a) të sigurojë që punëdhënësi plotëson kriteret e përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi, për zbatimin e kontratës së punës për mësimin e profesionit (aneks II);

b) të trajtojë dhe certifikojë mentorët e caktuar nga punëdhënësi, për udhëheqjen e nxënësve, që mësojnë profesionin;

c) të vendosë në dispozicion të punëdhënësit informacione mbi nxënësin që mëson profesionin, në lidhje me kualifikimin profesional, programin e pjesës praktike të skeletkurrikulave të zbatuar në vendin e punës, si dhe informacione të tjera verifikuese për nxënësit;

d) të ndihmojë në pajisjen e nxënësve me vërtetimin e aftësisë për punë sipas kualifikimeve profesionale dhe udhëzimeve në fuqi;

e) të mbikëqyrin mbarëvajtjen e zbatimit të programit profesional përkatës të punëdhënësi, ku zbatohet kontrata e mësimit të profesionit në formën e dyfishtë;

f) të mbajë dhe plotësojë përmes mësuesit të kulturës profesionale përgjegjës për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, evidencat për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive për mësimin e profesionit në vendin e punës (plani i punës, fletorja e vlerësimit etj.);

g) të sigurojë vlerësimin e nxënësit që mëson profesionin në bashkëpunim të ngushtë me mentorin.

Neni 4

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Palët do ta përdorin informacionin e shkëmbyer vetëm me qëllim të ushtrimit të funksioneve të tyre ligjore.

2. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Përmbajtja e çdo kërkesë për informacion, e bërë në bazë të kësaj marrëveshjeje, do të trajtohet si konfidenciale nga të dyja palët në marrëveshje, përveç rastit kur palët me marrëveshje parashikojnë ndryshe.

4. Informacion i përpunuar gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes do të trajtohet si konfidencial në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe ka vlefshmëri për sa kohë zgjat plani mësimor i cili do të lëvrohet në arsimin dhe formimin profesional të formës së dyfishtë.

2. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila prej palëve me njoftim paraprak me shkrim prej 30 ditësh dërguar palës apo palëve të tjera.

3. Aktivitetet që janë në proces në momentin e përfundimit të marrëveshjes do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshje.

Neni 6 Ndryshimet

1. Çdo ndryshim në këtë marrëveshje bashkëpunimi, kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.

2. Palët në vullnetin e tyre iniciojnë ndryshimin e detyrimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit sipas nevojave dhe problematikave që hasen.

3. Ndryshimet hyjnë në fuqi, pas nënshkrimit të tyre.

Neni 7 Efekti financiar

1. Çdo palë merr përsipër shpenzimet e veta dhe i siguron vetes burime për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.

2. Të gjitha aktivitetet sipas kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, do t'i nënshtrohen disponueshmërisë së burimeve financiare dhe njerëzore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8 Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet në 2 kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë dhe me të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore secila.

DATA _____._____._____
Për IOAFP/

Drejtori

DATA _____._____._____
Për Punëdhënësin

SHTOJCA NR. 3

Fletë vlerësimi nga mentori për kompetencat profesionale dhe personale të nxënësit që mëson profesionin në mjediset e punës

Shpjegim. Ky instrument përdoret për vlerësimin e kompetencave profesionale dhe personale të nxënësve që mësojnë profesionin në përmblyllje të veprimtarisë së plotë të zhvilluar në vendin e punës për mësimin e profesionit. Është përgjegjësi e mësuesit të kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës së punës për mësimin e profesionit të udhëzojë mentorin mbi plotësimin e këtij formati. Mbani parasysh që kualifikimi profesional i shënuar në këtë fletë vlerësimi është për efekt shembulli.

Fletë vlerësimi nga mentori për kompetencat profesionale dhe të përgjithshme të nxënësit që mëson profesionin gjatë punës për mësimin e profesionit

Kualifikimi profesional: Kuzhinë duale, niveli III KSHK, klasa XII

Punëdhënësi: _____ Mentori : _____

Mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit _____

Nxënësi që mëson profesionin: _____

Periudha e vlerësimit: _____ Data e dorëzimit: _____

Veprimtaria: Përgatit ushqime për mëngjesin kontinental, anglez, tradicional dhe Brunch.

Kompetencat		Vlerësimi				
		1	2	3	4	5
Kompetenca profesionale	Të organizojë vendin e punës.					
	Të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse sipas menusë dhe recetës.					
	Të përgatitë lëndët e para dhe ndihmëse për mëngjeset, sipas recetave.					
	Të realizojë etapat e procesit teknologjik.					
	Të marinojë përbërësit sipas recetave					
	Të erëzojë dhe të shijezojë përbërësit sipas recetave.					
	Të kryejë vlerësimin organo-shqisor të produkteve.					
	Të kompozojë produktet e përgatitura, sipas llojit të mëngjesëve dhe rregullave të estetikës.					
	Të llogaritë koston e produkteve të përgatitura.					
Kompetenca personale	Të komunikojë në mënyrë etike dhe profesionale.					
	Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave të pranuar.					
	Të manifestojë aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.					
	Të bëjë vlerësimin dhe vetëvlerësimin nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe për të çuar më tej arritjet e tij.					
	Të zbatojë orarin e punës.					
	Të jetë i aftë për zgjidhjen e problemeve.					
	Të jetë i besueshëm dhe të kujdeset për të mirat materiale.					
	Të menaxhojë situata dhe të zgjidhë konflikte.					
	Të jetë i saktë në punë.					
	Të dorëzojë në kohë detyrat/produktet.					
	Të jetë i aftë për të ndërmarrë iniciativë, të jetë fleksibël dhe krijues, në kërkim të gjetjeve të reja.					
	Të përdorë teknologjinë.					

Sugjerime të tjera nga mentorinevojat për përmirësim:

Sistemi i pikëzimit:

- 5 – *Shkëlqyeshëm*: përmbush të gjitha standardet.
- 4 – *Shumë mirë*: përmbush shumicën e standardeve.
- 3 – *Mirë*: përmbush disa standarde.
- 2 – *Mjaftueshëm*: përmbush pak standarde.
- 1 – *Dobët*: nuk përmbush asnjë standard.

Mesatarja e pikëve në total	1-1,2	1,3- 2	2,1-2,9	3 - 3,6	3,7-4,4	4,5-4,9	5
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Nënshkrimi i nxënësit

Nënshkrimi i mentorit

Nënshkrimi i mësuesit

SHTOJCA NR. 4

Formular vlerësimi për përmbushjen e kriterëve të punëdhënësit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit

Emri i punëdhënësit: _____

Përfaqësues ligjor: _____

NIPT/NUIS: _____

Punëdhënësi i sipërcituar konsiderohet i përshtatshëm për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit në arsimin e dyfishtë, nëse përmbush kriteret e mëposhtme:

Kriteret e përzgjedhjes së punëdhënësit për zbatimin e kontratës së mësimin të profesionit		Përmbyshet		Dokument mbështetës
		Po	Jo	
Aspekte ligjore				
1	Është subjekt i regjistruar në QKB			Ekstrakt i thjeshtë/ historik
2	Operon në treg prej të paktën 3 (tre) vjet			
3	Ushtron veprimtarinë në kualifikimet profesionale të kërkuara nga IoAFP			
4	Ka të paktën 2 (dy) punonjës të punësuar me kohë të plotë			Vërtetim*
Aspekte të zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit				
1	Angazhon një mentor të punësuar prej tij për të mbikëqyrur, trajnuar e vlerësuar nxënësin që mëson profesionin gjatë pjesës praktike të skeletkurrikulës.			N/A
2	Mundëson vend pune që përshtatet me natyrën e punës për mësimin e profesionit, në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë.			Relacion i përgatitur nga specialisti i IoAFP
3	Zotëron dhe vendos në dispozicion infrastrukturën e nevojshme (pajisje, materiale pune etj.) në funksion të realizimit të kontratës për mësimin e profesionit për zbatimin e skeletkurrikulës përkatëse.			
4	Mbështet trajnimin e mentorit për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit, brenda 3 muajve nga nënshkrimi i marrëveshjes.			N/A
5	Deklaron vendet vakante për mësimin e profesionit përpara nënshkrimit të kontratës për mësimin e profesionit.			N/A

Dokumentet mbështetëse i bashkëlidhen këtij dokumenti.

Përfaqësues nga IOAFP-ja

Përfaqësues nga Punëdhënësi

***Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin- E-SIG 02/a – e-Albania**

Relacion për inspektimin e vendit të punës dhe kapaciteteve infrastrukturore të punëdhënësit për ofrimin e vendit të punës për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë

Emri i punëdhënësit: _____

Përfaqësues ligjor: _____

NIPT/NUIS: _____

Bazuar në inspektimin e kryer në mjediset e punëdhënësit, më datë _____. _____ për vlerësimin e mundësit të vendit të punës, mjeteve dhe kapaciteteve infrastrukturore për ofrimin e vendit të punës për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë, pasi verifikimit, konfirmoj se punëdhënësi:

☐ përmbysh

☐ nuk përmbysh

kriteret për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë, për ____ nxënës që mësojnë profesionin, regjistruar në programin _____, pranë IOAFP-së
 “ _____ ”.

Përfaqësues nga IOAFP-ja

Emër Mbiemër Firmë

Model**Formati i programit të veprimtarive për mësimin e profesionit në mjediset e punës**

Punëdhënësi:

Adresa:

Mentori:

Shkolla e mesme profesionale:

Data e fillimit dhe përfundimit të trajnimit për mësimin e profesionit:

Numri i nxënësve: (ose emrat nominale të nxënësve/it)

Profili mësimor; kuzhinë duale

Viti shkollor: 2024–2025

Klasa: XII, Niveli III KSHK

Nr.	Vendi i punës	Veprimtaritë	Periudha kohore e mësimit të profesionit		
			<i>Java/muaji</i>	<i>Data</i>	<i>Ora²/orët</i>
1	Mjedis i kuzhinës Sektori i përgatitjes së mëngjeseve dhe <i>Branch</i>	- Përgatit ushqime për mëngjesin kontinental.			
		- Përgatit ushqime për mëngjesin anglez.			
		- Përgatit ushqime për mëngjesin tradicional.			
		Përgatit ushqime për <i>Branch</i>			
2	Mjedis i kuzhinës	Veprimtaria 2			
3	Mjedis i kuzhinës	Veprimtaria 3			

Kompetencat profesionale dhe personale që nxënësi që mëson profesionin duhet të fitojë gjatë mësimit të profesionit të punëmarrësi:

Kompetencat profesionale:

Kompetencat personale:

² Orët që punon te punëdhënësi për secilën veprimtari.

SHTOJCA NR. 6

Model CV

Adresa: [Adresa e plotë] Telefon: [Numri i Telefonit] Email: [Adresa e <i>email</i> -it] Datëlindja [Data e lindjes] Edukimi: [Emri i institucionit] [Kualifikimi profesional] [20XX–20XY] Trajnime [Emri i institucionit] [Emri i trajnimit] [Periudha]	EMËR MBIEMËR Kush jam unë: Përvoja e punës/praktikës [Emri i kompanisë] – [Kohëzgjatja] Përshkrimi i detyrave dhe aftësive të fituara: Aftësitë profesionale [Përmendni aftësitë që keni zhvilluar gjatë punës, praktikës apo trajnimit, si për shembull njohuri për softuer të caktuar, makineri, instrumente specifike të industrisë etj.] Gjuhë të huaja [Emri i gjuhës së huaj] – [niveli i gjuhës] Pjesëmarrje në aktivitete [Përmendni aktivitetet që lidhen me profesionin tuaj ose që mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive profesionale, si për shembull projekte, pjesëmarrje në konkurse etj.] Referenca [Emri i personit] [Emri i kompanisë ose Institucionit] [Telefon/email]
---	--

SHTOJCA NR. 7

Format për programin e përgjithshëm i veprimtarive për mësimin e profesionit në mjediset e punës

Shkolla profesionale

Profili mësimor: (shembull) kuzhinë duale, niveli

Klasa:

Punëdhënësi:

Mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.....

Mentori

Viti shkollor

Nr.	Vendi i punës	Veprimtaritë	Kompetencat profesionale	Koha (ditë)
1				
2				
3				
4				
5				
TOTALI				X ditë

SHTOJCA NR. 8

Portofoli i veprimtarive të punës të nxënësit që mëson profesionin në mjedisin e punës

1. Fletorja e praktikës së punës për nxënësin që mëson profesionin në mjediset e punës për mësimin e profesionit.

Shpjegim. Fletorja e praktikës së punës për nxënësin që mëson profesionin përfshihet në vlerësimin e vazhduar të nxënësit gjatë mëimit të profesionit te punëdhënësi. Mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit dhe përgjegjësi i departamentit mësues sigurohet që nxënësit të pajisen me fletoren e praktikës së punës për mësimin e profesionit dhe, së bashku me mentorin e ngarkuar nga punëdhënësi, ndjekin plotësimin e rregullt të tyre. Fletorja e praktikës së punës për mësimin e profesionit kontrollon rregullisht dhe nënshkruhet nga mentori dhe mësuesi i kulturës profesionale përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.

Data: _____

Emri i nxënësit që mëson profesionin: _____

Punëdhënësi: _____

Drejtimi/profili: _____

Emri i mentorit: _____

Klasa: _____

Emri i mësuesit të kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit: _____

Detyrat dhe veprimtaritë e kryera	Vendi i punës	Koha (ditë/orë)
–		
Kompetenca profesionale të përvetësuara		
–		
Kompetenca profesionale të përvetësuara		
–		
Procese/teknologji të reja me të cilat jam njohur gjatë punës		
–		

Nxënësit që mëson profesionin:

Mentorit:

Mësuesit të kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit

2. Raport me reflektime konkrete gjatë mëimit të profesionit në mjediset e punës

Emër Mbiemër _____ drejtimi/profili _____ klasa _____

Punëdhënësi _____

Data: ____ . ____ . ____

1. Sot unë jam njohur me këto:

Veprimtari të reja:

Procese të punës: _____

2. Sfidat/vështirësitë me të cilat u përballa:	
3. Kompetencat e reja që përfitova:	
4. Tjetër:	

Nxënësi që mëson profesionin

Mentori

6. Evidenca gjatë zbatimit të veprimtarive sipas planit mësimor të mësimit të profesionit në mjediset e punës.

Shpjegim. Ky format është pjesë e portofolit të nxënësit që mëson profesionin. Në të nxënësi paraqet të gjithë eksperiencën e tij gjatë zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit. Përshteruar aftësitë që ka mësuar, veprimtaritë që ka kryer dhe evidenca me foto, projekte, linqe etj. Vlerësohet nga mësuesi i kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit dhe mentori.

Emri mbiemri i nxënësit që mëson profesionin: _____ Punëdhënësi : _____

Klasa: _____ Drejtimi/profili: _____

1.1 Veprimtaritë e zhvilluara	
1.2 Dokumentimi me foto, skicë ose link	
1.3 Vëzhgim dhe reflektim gjatë zhvillimit të veprimtarive	
1.4 Kompetencat e fituara	

Model

Vërtetim/letër reference

Po ju shkruaj këtë vërtetim/letër reference, për nxënësin _____, nga shkolla profesionale _____, në vitin _____, në kualifikimin (drejtimi/profili)_____, për të cilin/ën unë besoj se do të bëhej një punonjës/e i/e jashtëzakonshëm në fushën e _____. Përkushtimi i saj/tij ndaj gjatë mësimi të profesionit, niveli i arritur i aftësive profesionale e personale, si dhe gatishmëria për të mësuar, janë të gjitha cilësitë ideale për një praktikant ose punonjës të ardhshëm.

_____ ka punuar në _____ nën mbikëqyrjen time/ e _____përgjatë zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit në arsimin e dyfishtë, me kohëzgjatje prej _____. Gjatë kësaj periudhe, ai/ajo ka mësuar dhe punuar me rigorozitet, korrektësi, seriozitet, vëmendje dhe përkushtim.

Aftësitë kryesore të _____ janë_____.

Nëse keni nevojë për informacion shtesë në lidhje me _____, ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni. Do të isha më se e/i lumtur të rekomandoja përvojën e _____.

Përsëndetje të singerta,
[Emër Mbiemër]
[Emri i punëdhënësit]

Firma
Vula (nëse ka)